




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, indo.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Procesverbal

Nga seancën e **XI (njëmbëdhjetë)** të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, mbajtur më 12.12.2012 me këtë:

REND PUNE

1. Konstatimi i prezencës dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,
2. **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:**
 - 2/1. Propozim vendimi për shpallje "Qytetar Nderi" të Gjilanit, të ish Senatorit z. Robert Joseph Semore "Bob Dole"
 - 2/2. Propozim vendimi për miratimin e Planit Rregullues Urban: "**Dheu i Bardhë -1**";
 - 2/3. Propozim vendimi për miratimin e Planit Rregullues Urban: "**Qeshma e Petigovcit**";
 - 2/4. Propozim vendimi për miratimin e Planit Rregullues Urban: "**Gllama**",
 - 2/5. Propozim vendimi për miratimin e Planit Rregullues Urban: "**Dheu i Bardhë -2**",
 - 2/6. Propozim vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi sipas Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL,
 - 2/7. Strategjia për Zhvillimin Kulturor të Komunës së Gjilanit (2012-2016),
 - 2/8. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për konservimin dhe mirëmbajtjen e Stadiumit të Qytetit.
3. Të ndryshme,

Seanca i filloi punimet në ora 9.00

Kryesuesi i seancës
Izmi Zeka

Në punimet e Seancës së njëmbëdhjetë (XI) morën pjesë:

Kryetari i Komunës, z. Qemajl Mustafa

Anëtarët e Kuvendit

Përfaqësuesi për Mbrojtën e të Drejtave të Njeriut, z. Fazli Abdullahu

Përfaqësuesi i OSB-së, z. Basri Sejdiu

Përfaqësuesi i Forumit Demokratik “Anamorave”, z. Isa Shefkriu

Përfaqësuesi i Shoqërisë Civile, z. Shaban Terziu

Seancën e njëmbëdhjetë e hapi dhe udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit z. Izmi Zeka i cili i përshëndeti anëtarët e Kuvendit dhe të gjithë të pranishmit e tjerë në sallë të cilët i monitorojnë punimet e seancës së njëmbëdhjetë dhe kërkoi nga sekretaria e Kuvendit që të verifikohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit në punimet e kësaj seance.

1. Konstatimi i prezencës dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,

Nga ana e sekretarisë u verifikuar se në punimet e seancës së XI (njëmbëdhjetë) janë të pranishëm 38 anëtarë të Kuvendit, kurse mungojnë tre (3):

- Sabedin Kadriu

- Arianit Sllmniku

- Selim Selimi

Procesverbali

Nuk pati vërejtje në procesverbal i cili u aprovua pa vërejtje

Izmi Zeka- përkitazi me rendin e punës edhe në KPF jemi pajtuar që të jetë ky rend i punës, por edhe në seancën e kaluar gjithashtu, prandaj propozoj që deklaroheni se a pajtoheni me këtë rend të punës?

Sokol Haziri- unë nuk e mora fjalën për të propozuar ndonjë pikë të rendit të ditës, por në emër subjektiv politik të cilit i takoj shfrytëzoj rasatin që t’i falënderoj të gjitha grupet politike të cilët në forma të ndryshme na uruan dhe na përgëzuan për kthimin e liderit tonë Ramush Haradinajt nga Gjakata a Hagës. Unë mendoj se kësaj here qytetarët e Gjilanit kanë treguar kulturën e lartë politike dhe kanë dëshmuar se me këtë rast nuk kemi të bëjmë vetëm me një lider partiak, por kthimi i tij është konsideruar si një çështje më e madhe për vendin, prandaj edhe njëherë iu falënderoj, sepse Ramush Haradinaj nuk është vetëm një lider partiak, por i takon të gjithëve.

Arben Mehmeti- atë që e tha Sokoli nuk kam çka t’i shtoj, ajo është çështje politike, po më intereson se a do të jetë kryeministër Ramush Haradinaj apo jo?

Sa i përket pikave të rendit të punës ne disa herë i kemi bërë disa pyetje dhe kemi kërkuar që të na epen përgjigje në këtë Kuvend, por ato përgjigje ose nuk po na epen fare ose po vonohen dhe ato më bëhen të paarsyeshme kur po na ofrohen?

Në seancën e kaluar kemi kërkuar përgjigje për Mirëmbajtje të rrugëve e cila përgjigje sot na ofrohet, kur tash e kemi problemin e mirëmbajtjes dimërore të rrugëve.

Ky është problem serioz në mes neve si Kuvend dhe i drejtorive përkatëse. Të jetë kjo një vërejtje shumë serioze dhe në momentin që kërkohet ndonjë përgjigje, ajo të jetë efikase dhe të na ofrohet me shkrim nëse nuk është afër ndonjë seancë! Gjithashtu kërkojmë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike që të jetë më tepër e përqendruar në çështje të trotuareve në qytet dhe fshatra, sepse këto ditë ka ndodhur një fatkeqësi (viktimë), në fshatin Zhegër për shkak të mos rregullimit të trotuarit. Ne shumë herë kemi kërkuar që çështja e trotuareve të jetë prioritet për Komunën e Gjilanit i cili nuk kërkon investim të madh, por është me interes të madh dhe shumë i nevojshëm për qytetarët e Komunës së Gjilanit. Gjithashtu ne në seancat e kaluara kemi kërkuar një informatë me shkrim për Bibliotekën e qytetit (punët që po bëhen aty) e cila gjithashtu nuk na është ofruar! Gjithashtu kemi kërkuar një informatë për çështjen e problemit në Shkollën Fillore “Thimi Mitoko” e cila enda nuk na është ofruar! Nën të ndryshme do të bëjmë disa kërkesa për disa drejtori për të marrë informatë se deri ku kanë lëvizur disa procese?

Elisah Ymeri – Unë do ta bëj një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike? A ka mirëmbajtje të rrugëve dhe kush është duke i mirëmbajt? Nëse ka ndonjë kompani të tillë ajo nuk është duke i mirëmbajt fare rrugët ose po i mirëmban shumë keq!

Sami Azemi- edhe unë gjithashtu e kam një kërkesë për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, sepse në drejtimin Gjilan- Pogradec, janë hapur disa gropa të cilat nuk janë sanuar fare edhe kur është bërë arnimi i rrugës. Mirëpo edhe kur është bërë arnimi i rrugës është bërë vetëm deri në fshatin Uglar, kurse nuk ka vazhduar më tutje. Duhet ditur se edhe ne jemi tatim pagues dhe jemi qytetarë të Komunës së Gjilanit dhe nuk e gëzon askush atë të drejtë për ta sanksionuar fshatin Pogradec!

Rashit Sahiti- unë e kam një pyetje për një drejtor i cili aktualisht nuk është i pranishëm, por me siguri do të informohet lidhur me këtë pyetje! Për çfarë arsyeje që tri vjet ende nuk janë emërtuar tri shkolla në Komunë të Gjilanit? Kjo çështje kërkon zgjidhje, sepse duhet ta kenë emrin ato shkolla dhe jo të thuhet Shkolla në këtë apo atë lagje! Kemi personalitete të mjaftueshme për t’i emërtuar këto shkolla, prandaj kërkoj përgjigje se ku ka mbet kjo çështje?

Izmi Zeka- kryesuesi kërkon nga anëtarët e Kuvendit që të deklarohen se a pajtohen me këtë rend të punës ashtu si është propozuar me pikën të ndryshme ashtu si kërkoi Arben Mehmeti ?

Aprovohet rendi i punës me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm të Kuvendit

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

2/1. Propozim vendimi për shpallje “Qytetar Nderi” të Gjilanit, të ish Senatorit z.Robert Joseph Semore “Bob Dole”

Izmi Zeka- unë fillimisht i përshëndes OJQ “Miqtë e Amerikës” të cilët janë prezent në këtë seancë të cilët po na nderojnë me pjesëmarrjen e tyre dhe ne i përshëndesim për këtë gjest të mirë. Ne dhe në KPF kemi debatuar për ta shpallur Qytetar Nderi Bob Dollin, kurse sot pasi e kemi këtu kryetarin e kësaj OJQ, Agim Rexhepi e lus që ta merr fjalën.

Agim Rexhepi- i nderuari kryetari i Komunës, kryesues i Kuvendit të Komunës, përfaqësues të Shoqërisë Civile dhe ju të mediejeve jam i privilegjuar që gjendem sot para juve për t’ i thënë disa fjalë lidhur me nismën tonë. Sa për informacion po theksoj se senatori i SHBA-ve, z. Bob Dole ka qenë një aleat i ynë në një periudhë mbi 15 vjeçare dhe asnjëherë nuk është ndalur për të punuar në interes të aspiratave tona nacionale. Unë muajin e kaluar jam takuar në SHBA me ish Presidentin Amerikan Bill Clinton të cilin e informova për iniciativën të cilën e kemi marrë, por e kam informuar edhe asistenten personale të z. Bob Dole i cili është në gjendje mjaft të rëndë shëndetësore. Por ajo çka është më me rëndësi për këtë nismë e kam informuar edhe miqtë e mi të Stej Departamentit të SHBA-ve. Z. Agim Rexhepi në fjalën e tij dha edhe disa sqarime për arsyen pse propozohet z. Bob Dole për ta shpallë Qytetar Nderi të Komunës sonë.

Izmi Zeka- ne si Kuvend dhe KPF në çastin që e kemi marrë këtë kërkesë nuk kemi hezituar për këtë çështje, sepse përveç Bob Dolit, janë edhe shumë personalitete Amerikane të cilët meritojnë për të qenë qytetarë nderi të Gjilanit dhe të Kosovës. Shumë personalitet në SHBA kanë bërë angazhime jetësore për Kosovën dhe pa miqtë amerikanë, ne nuk do të ishim ta që jemi sot.

Mirëpo z. Dole në kontinuitet i ka mbrojtur interesat e shqiptarëve në Kosovë dhe përgjithësi kudo që gjenden. Për këtë arsyeje më tepër është privilegj për neve se sa për Bob Dolin, por është edhe mirënjohje për neve që na është dhënë ky rast që ta shpallim Qytetar Nderi këtë personalitet!

Sokol Haziri- i nderuari kryesues është nder dhe kënaqësi që ky Kuvend ka këtë mundësi dhe këtë rast që z. Bob Dole ta shpall Qytetar Nderi të qytetit tonë. Unë në emër të grupit tim të AAK-së e mbështesë pa rezervë këtë nismë.

Arben Mehmeti- ne si LDK, mendojmë se kjo çështje ka qenë desh të ndodh edhe më herët, por mendojmë se KK- i Gjilanit ndoshta është një institucion jo adekuat për ta shpall Qytetar Nderi një senator si Bob Doli i cili ka qenë mik i ngushtë i ish Presidentit të Kosovës dr. Ibrahim Rugova i cili fat lidhet shumë me subjektin tonë politik. Neve kjo nismë na bën nder shumë si subjekt dhe i bën nderë të gjithë qytetarëve dhe institucioneve të Republikës së Kosovës. Ky është rast i veçantë për Komunën e Gjilanit dhe është rast për t’ u shënuar në histori me faktin se po e shpallim Qytetar Nderi një personalitet të shekullit për interesa të Kosovës.

Ejup Haziri- edhe për grupin e PDK-së është kënaqësi e rrallë për të shpall Qytetar Nderi një personalitet të tillë të qytetit tonë.

Arben Malqi- ky është një privilegj i madh së pari për neve kuvendarët që kemi rast që ta shpallim Qytetar Nderi një njeri të madh i cili pareshtur ka punuar e ka përkrahur Kosovën dhe kemi kënaqësi të veçantë për këtë gjest që po e bëjmë sot.

Leonorë Bunjkau- edhe ne si grup kemi kënaqësi të posaçme që jemi pjesë e këtij Kuvendi, kur po shpallet Qytetar Nderi i qytet tonë një personalitet siç është Bob Doli. I urojmë shëndet senatorit dhe mikut tonë të respektuar, me kënaqësi e pranuar këtë propozim.

Qemajl Mustafa- përshëndetje për të gjithë, por në mënyrë të veçantë për përfaqësuesit e OJQ-së “Miq të Amerikës” dhe të tjerët. Ne natyrisht me kënaqësi e kemi pranuar këtë nismë dhe po theksoj se ka shumë personalitete të cilat meritojnë të jenë qytetarë nderi të komunave tona, të Kosovës dhe të hapësirave shqiptare përgjithësisht. Ata që e dinë historinë e kanë të njohur se SHBA-të se nuk janë miq ad-hok të shqiptarëve, nuk janë vetëm sot dhe nuk janë vetëm në vitet 80-90- ta, por janë që nga viti 1912 e këndej.

Për këtë arsyeje me të drejtë kryesuesi e tha ne më shumë i bëjmë nder vetes sonë si Kuvend i Komunës që po e shpallim një personalitet të tillë Qytetar të Nderit i cili është edhe në moshë të shtyrë, por edhe në gjendje të rëndë shëndetësore. Mirëpo edhe po mos të ishte në jetë ne do të duhej ta bënim këtë veprim edhe postmortum, sepse nderi më shumë i takon Komunës së Gjilanit se sa që i shkon z. Bob Doli.

Ju falënderoj për këtë nismë dhe e lus kryesuesin që ta shpall Qytetar Nderi senatorin Bob Dole!

Izmi Zeka- po shihet se tash është vetëm një aspekt teknik, prandaj kërkoj që të deklaroheni se kush është për aprovim të këtij propozim-vendimi dhe senatori Bob Dole të shpallet Qytetar Nderi i Komunës së Gjilanit ?

Aprovohet pika 2/1 e rendit të punës: Propozim vendimi për shpallje “Qytetar Nderi” të Gjilanit, të ish Senatorit z.Robert Joseph Semore “Bob Dole” me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit, me të cilin rast të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe të pranishmit tjerë në sallë u ngritën në këmbë dhe i duartrokitën këtij vendimi të KK-së.

Një fjalë përfundimtare në këtë rast e tha edhe kryesuesi i Kuvendit, Izmi Zeka dhe kryetari i OJQ “Miq të Amerikës”, z. Agim Rexhepi.

2/6. Propozim vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi sipas Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL,

Izmi Zeka- për këtë pikë të rendit të punës, kryesuesi fjalën ia bartë, zv/kryetarit të Komunës.

Omer Daku- i përshëndes të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe të pranishmit e tjerë në këtë seancë dhe së pari iu njoftoj se në këtë Këshill ka ndodhur një ndryshim nga MPB me datë 22.8 2012, prandaj në bazë të kësaj edhe ne duhet të bëjmë korrigjime ose ta bëjmë plotësimin me anëtarë të këtij këshilli përbërja e të cilit është:

Qemajl Mustafa, Kryetar Komunës,

1. _____Komandant i Stacionit policor,
2. Përfaqësuesit legjitim të secilës bashkësi fetare,
3. Përfaqësuesit e secilit komunitet,

4. Kryesuesi I Komitetit për Komunitete,,
5. Zyrtari për barazi gjinore,
6. Drejtori I Drejtorisë për Arsim,
7. Kryetari I Këshillit të prindërve të Arsimit të Komunës,
8. Përfaqësuesi I FSK-së,
9. Një përfaqësues I secilit Këshill Lokal për Siguri në Bashkësi,
10. Kryesuesi I Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi,
11. Përfaqësuesi I sektorit të Emergjencës Civile,
12. Përfaqësuesi I Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim,
13. Një përfaqësues nga OJQ, mediat lokale, komuniteti i biznesit dhe një përfaqësues I komunitetit të personave me aftësi të kufizuar,

Ky Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi detyrat, përgjegjësit dhe funksionin do t'i kryejë bazuar në Udhëzimin administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Për punën e tyre anëtarët e KKSB-së paguhën nga buxheti i Komunës në shumën ekuivalente të anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha aktet e miratuara nga KK-Gjilan për themelimin e KKSB-së.

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Kryetari I Komunës, ndërsa për implementimin e tij kujdeset Kryesuesi I KK-Gjilan.

Arben Mehmeti- unë adresoj kritikë lidhur me këtë Këshill të Ministria e Punëve të Brendshme, sepse kjo ministri i ka anashkaluar kuvendet komunale dhe ne nuk jemi pyetur fare për formimin e këtij këshilli. Nuk mund ky Këshill Komunal të formohet në bazë të një Udhëzimi administrativ, kurse kuvendet e komunave të jenë vetëm instrumente teknike të këtij udhëzimi. Ky është obligim i Kuvendit të Komunës për ta themeluar këtë këshill e jo ne vetëm ta bëjmë pagesën dhe të mos pyetemi fare për formim të këtij Këshilli. Në kërkojmë që të ndryshohen këto udhëzime administrative dhe të barten në nivel komunal këto çështje.

Gjithashtu edhe këta emra të këtij komisioni duhet të vijnë këtu dhe ne t' i diskutojmë dhe jo në asnjë mënyrë të na servohen kështu në tavolinë.

Unë nuk jam për ta aprovuar një dokument, ku ne si Kuvend konsiderohemi si instrument teknik i një ministrie.

Sokol Haziri- unë nuk e kam të qartë pse duhet të debatohet në Kuvend për këtë propozim, sepse ky propozim është bërë sipas një Udhëzimi administrativ nga MPB-ja i cili udhëzim i ka përcaktuar kornizat, emrat dhe nuk ka nevojë të merret me këtë KK. Kjo sipas këtij udhëzimi është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e MPB-së. Unë nuk e kam të qartë pse është propozuar për Kuvend dhe konsideroj se ne nuk kemi nevojë fare të votojmë.

Brenga kryesore është se është anashkaluar përfaqësimi i Kuvendit Komunal në këtë përbërje dhe autoriteti më i lartë i Komunës mbetet i anashkaluar dhe unë e adresoj këtu një vërejtje dhe nuk është e nevojshme fare të votohet për këtë çështje.

Arben Maliqi- unë fillimisht e falënderoj këtë Këshill i cili ka funksionuar për mrekulli dhe po thaj është e vetmja Komuna e Gjilanit e cila mund të lavdërohet me këtë Këshill.

Ky Këshill është për të mirë të qytetarëve të Gjilanit, por edhe unë pajtohem me parafolësin që pasi ne marrim pjesë drejtpërdrejtë në këtë Këshill, ne duhet të pyetemi për këtë rast, por pasi që nuk jemi pyet fare edhe unë nuk e shoh të arsyeshme që ta votojmë.

Leonorë Bunjkau- në këtë këshill, unë kam qenë edhe anëtare, sepse propozimet janë bërë nga subjektet politike edhe unë kam qenë anëtare vullnetare e këtij këshilli. Mirëpo në takimin e fundit propozuam që në këtë këshill duhet të propozohet nga një anëtar për çdo subjekt politik, sepse subjektet politike nuk do t' i bëjnë dëm këtij Këshilli, por përkundrazi do të kishim qasje më të përafërt se çka është duke u punuar në këtë këshill.

Omer Daku- në këtë komision janë individët që gjenden në pozita të caktuara dhe ne nuk kemi mundësi për t' i ndryshuar emrat. Sa i përket disa pozitive sidomos të komuniteteve tjerë siç është rasti me komunitetin turk etj janë disa pozicione që ne nuk mund t' i ndryshojmë, gjithashtu nga komuniteti serb, ata e kanë bërë propozimin. Kështu është çështja me personat me aftësi të kufizuara dhe nga mediet, ne nuk kemi dhënë asnjë propozim, por mandati i tyre zgjat baras me mandatin e këshilltarëve komunal. Unë mendoj se në parim për këtë mandat duhet të jenë këta emra.

Arben Mehmeti- këtu ka përfaqësues nga të gjitha komunitetet edhe nga ata serbe, turk etj. Mirëpo ne nuk mund dhe nuk duhet të lejojmë që të vijë dikush në këtë Këshill, sidomos nga komuniteti për pa e ditur se kush është ai? Këtë po e them se ka pasur raste që në nivel të Kosovës është propozuar ndonjë kandidat që ka qenë edhe paramilitar gjatë kohës së luftës.

Unë nuk jam për ta aprovuar këtë pikë të rendit të punës dhe duhet treguar MPB-së se Kuvendi nuk është instrument teknik i askujt dhe i ftoj anëtarët e Kuvendit që mos ta votojnë këtë propozim vendim në këtë formë.

Izmi Zeka- ne e kemi të qartë që udhëzimet administrative nuk i votojmë, por ne i votojmë vetëm emrat. Mirëpo ne këtë mund t' i lëmë kryetarit dhe zv/kryetarit që të merren me ekzekutimin e kësaj çështje, sepse këta janë në ngjarje. Unë jam në ngjarje për këtë rast dhe mund të them lirisht se ky këshill në Komunë të Gjilanit është shumë në nivel në krahasim me komunat e tjera.

Sadudin Berisha- nëse ekziston një udhëzim administrativ mbi bazën e ligjit në fuqi, ai Udhëzim automatikisht i përcakton kriteret dhe kushtet në mënyrë taksative.

Nëse thuhet sot nga kryesuesi se ne sot vetëm duhet t' i miratojmë kriteret e Udhëzimit administrativ, vërtetë është shumë qesharake. Ku është exo-ficio, sipas detyrës zyrtare për të qenë pjesë e këtij Këshilli, aty nuk kemi çka të bisedojmë, sepse njeriu dihet me emër dhe mbiemër, por kur nuk dihet se kë duhet ta delegojmë një përfaqësues një mekanizëm i caktuar do të duhej KK të bëjë kërkesë te ai mekanizëm, të kërkojë që të plotësohet një kriter i cili kërkohet me ligj dhe Udhëzim administrativ (ajo a është bërë)? Unë këtu nuk e shoh se është bërë nga fakti se kryesuesi (kryetari) thotë se duhet të jetë ai që ka qenë deri më dje.

Në këtë mënyrë e drejta dhe vullneti i anëtarëve të Kuvendit thjeshtë anashkalohet se a duhet apo jo të vazhdojë i njëjti, apo duhet të emërohet dikush tjetër? Për këtë arsyeje udhëzimi duhet të shpjegohet qartë, drejt dhe dha ashtu duhet të zbatohet! Nëse thuhet se

vetëm duhet ta miratojmë kriterin, nuk kemi nevojë, sepse kriterin e ka miratuar dikush tjetër. Deri më tash roli i jonë është se a do t' i pranojmë emrat e atyre që duhet të jenë përfaqësues të një grupimi politik e që nuk janë exo-ficio të precizuara në udhëzim administrativ.

Izmi Zeka- kush është për aprovim të kësaj pike të rendit të punës?

Aprovohet pika 2/6 e rendit të punës: Propozim vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi sipas Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL me 17 vota të anëtarëve të Kuvendit, 15 ishin kundër, kurse të tjerët abstenuan

2/8 . Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për konservimin dhe mirëmbajtjen e Stadiumit të Qytetit.

Veton Nevzadi- tash sezoni vjeshtor i garave po përfundon në futboll dhe ne duhet patjetër të investojmë në konservimin dhe ruajtjen e këtij stadiumi në mënyrë që të kemi një gjendje më të mirë në pranverë. Për këtë arsyeje kërkojmë nga ana e juaj që të na lejoni mjete financiare për një punë të tillë e cila do të jetë në dobi të futbollit dhe sportit në përgjithësi.

Vlerën e shumës për këtë qëllim e keni në materialet e juaja së bashku me arsyetimin, prandaj kërkoj nga ju që ta aprovoni këtë propozim?

Izmi Zeka- kush është për aprovim të kësaj pike të rendit të punës?

Aprovohet pika 2/8 e rendit të punës2/8: Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për konservimin dhe mirëmbajtjen e Stadiumit të Qytetit, me 24 vota të anëtarëve të Kuvendit,

2/7 Strategjia për Zhvillimin Kulturor të Komunës së Gjilanit (2012- 2016),

Bujar Haziri- lidhur me këtë strategji, arsyetimin e dha, zyrtari i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, z. Bujar Haziri, të cilën strategji anëtarët e Kuvendit e kanë pasur në materialin e seancës. Mirëpo pas arsyetimit të kësaj strategjie u kërkua nga anëtarët e Kuvendit që me vërejtjet e tyre dhe sugjerime ta plotësojmë edhe më mirë këtë strategji.

Arben Mehmeti- i pakënaqur me aprovimin e pikës 2/7, grupi parlamentar i LDK-së, kërkoi që të debatohet më gjerësisht për pikën 2/7; për ndarjen e mjeteve financiare për stadiumin e qytetit, sepse kishin vërejtje serioze për ndarje të mjeteve financiare për konservim, por kjo pikë u aprovua më parë dhe nuk iu dha kjo mundësi.

Në shenjë revolte grupi parlamentar i LDK-së doli nga salla e Kuvendit dhe nuk i vijuan punimet e mëtutjeshme të Kuvendit.

Izmi Zeka- kryesuesi i seancës kërkoi që të verifikohet edhe njëherë prezenca e anëtarëve të Kuvendit në sallë?

Nga ana e sekretarisë u konstatuar se për t' i vazhduar punimet e Kuvendit në sallë ishin të pranishëm 24 anëtarë, kurse punimet e seancës i lëshuan 14 anëtarë të Kuvendit (i tërë grupi parlamentar i LDK-së), kurse Sabdin Kadriu, Arianit Sllamniku dhe Selim Selimi), munguan që nga fillimi. Gjithsej munguan 17 anëtarë të Kuvendit.

Izmi Zeka- pasi që nga ana e sekretarisë u konstatuar se ka kuorum të mjaftueshëm ne mund të vazhdojmë me punë.

Sokol Haziri- mua më vjen keq për atë që ndodhi tash, por ne lidhur me rendin e punës në mënyrë konsensuale jemi marrë vesh në KPF, por edhe në fillim të kësaj seance. Mënyra se si u vepruar sot, është një gjest jo i mirë dhe e prish harmoninë e cila vazhdimisht ka qenë shembullore në Komunë të Gjilanit dhe nuk ka ndodhur që asnjëherë kur dikush të flet në foltore, ta ndërpres dikush tjetër! Këto veprime nuk i kontribuojnë mbrojtës së interesave të qytetarëve. Unë kërkoj që ky Kuvend të vazhdojë me punë ashtu siç e kemi pasur traditë në mënyrë të harmonizuar.

Izmi Zeka- ne e kemi krijuar një tolerancë të tepruar, prandaj edhe nganjëherë po na keqpërdoret kjo tolerancë e tepruar. Është e drejtë demokratike e çdokujt të qëndrojë në punime të seancës apo jo? Mirëpo nuk mund të lejojmë edhe ndërhyrje dhe keqpërdorime të foltore.

Tahir Arifi- kjo pikë e rendit të punës në Komitetin për Kulturë ka kaluar unanimisht dhe ka qenë në punë mjaft e madhe dhe voluminoze, në të cilin dokument është involvuar edhe Drejtoria e Kulturës. Kjo strategji është një dokument shumë i rëndësishëm për lëmit e kulturës. Ka plotë momente të mira brenda asaj strategjie të cilat mund t' i ndihmojnë institucionet komunale dhe sit ë tillë mendoj se duhet ta mbështesim dhe edhe njëherë po theksoj se në komitet ka kaluar me unitet të plotë.

Izmi Zeka- i lus anëtarët e Kuvendit të deklarojnë se kush është për aprovim të kësaj pike të rendit të punës?

Aprovohet pika 2/7 e rendit të punës: Strategjia për Zhvillimin Kulturor të Komunës së Gjilanit (2012- 2016), me 23 vota të anëtarëve të Kuvendit.

Veton Nevzadi- ne në pikën 2/7 patëm një pikë me shumë rëndësi për sportin gjilanas dhe konsideroj se stadiumi i Gjilanit nuk është vetëm i një partie dhe grupacioni të njerëzve, por është i tërë qytetarëve, të rinjve dhe të rejave gjilanasë. Me këtë veprim që ndodhi sot, të vetëdijshëm apo jo, iu bë në dëm dhe shërbim i keq sportit gjilanas.

Qëllimi i ynë ishte shumë parimor, ai qëllim ishte për t' i krijuar parakushte të rinjve dhe sportistëve për sezonin e ardhshëm pranveror.

2/3. Propozim vendimi për miratimin e Planit Rregullues Urban: “Qeshma e Petigovcit”;

Bahrie Mahmuti- me këtë propozim-vendim, kërkojmë që të miratohet Plani rregullues urban i lagjes “Qeshma e Petigovcit” i cili plan përfshin një sipërfaqe prej 21 hektarëve,

duke përfshirë hapësirën në mes Rrugëve: “Beqir Musliu”, mandej rrugën “Muharrem Ibrahim”, rrugën Qarkore “Nato 99” dhe rrugën “Nëna Terezë” të ashtuquajtur “Tuneli” e cila madje kthehet në të djathtë të “Qeshma e Petigovcit” dhe rrugën “Beqir Musliu” Hartuese e këtij plani është kompania nga Studio Projektuese “XL-Architects” me se seli në Prishtinë, përfaqësuesi i së cilës kompani gjendet këtu dhe të cilin e lusim që ta elaborojë edhe më detalisht këtë plan rregullues. Përfaqësuesi i kësaj kompanie është z. Arian Xhema, prandaj unë ia barti fjalën përfaqësuesit të kompanisë hartuese.

Arian Xhema- përfaqësuesi i Kompanisë “XL- Architects”, z. Arian Xhema në mënyrë detale me anë të kino-projektorit e elabori këtë plan para anëtarëve të Kuvendit.

Arben Maliqi- lidhur me këtë plan rregullues “Qeshma e Petigovcit”, konsideroj se ka qenë desh të bëhet shumë më herët, por për këtë fajin nuk mund të ia adresojmë kësaj qeverisje, por ndoshta edhe as asaj të kaluarës, sepse nuk kanë ekzistuar kushtet materiale, por konsideroj se më mirë është vonë se kurrë. Mirëpo për t’u bërë një plan i mirëfilltë duhet pasur parasysh disa gjëra e ajo më kryesorja duhet të kemi kujdes se si ta bëjmë shpronësimin, për t’i realizuar disa projekte me shumë rëndësi. Mirëpo ajo çka është me më shumë rëndësi të cilën kërkesë e kam bërë me rastin e aprovimit të çdo plani rregullues, duhet njëherë e përgjithmonë që menjëherë pasi të aprovohet ky plan, trasimi i rrugëve të bëhet patjetër. Kjo për mua është thelbësore për shkak se nëse e bëjmë këtë trasim, atëherë i ikim edhe manipulimeve.

Tensionit të lartë duhet t’i kushtojmë kujdes të veçantë dhe mos të lejojmë që të ndërtohen shtëpi nën këtë tension!

Mandej rëndësi të madhe duhet t’i kushtojmë gjelbërimit, sepse gjelbërimi është komponent relevante për planet rregulluese. Mandej te projektimi i objekteve me banim kolektiv duhet shumë të kemi kujdes, sepse duhet pasur hapësirë të mjaftueshme dhe jo sikur tash që objektet me banim kolektiv ndërtohen skaj rrugëve.

Këto objekte duhet t’i kenë parkingjet dhe të gjitha elementet e tjera përcjellëse të nevojshme për qytetarë.

Mandej kam një pyetje për drejtoreshën dhe përfaqësuesin e kompanisë hartuese që në këto raste të gjitha kabllot e ndryshme si të rrymës, rrjetit telefonik dhe rrjeteve të tjera që të futen në dhe, sepse i ka kaluar koha rrjetit dhe telave të ndryshëm në ajër.

Florinë Zymberi – duke u bazuar në dokumente e ofruara nga ekipi hartues dhe Drejtoria e Urbanizmit lirisht mund të them se është bërë një punë voluminoze me këtë plan dhe shumë detalisht i realizuar si plan. Mund të konstatoj se në këtë plan janë marrë për bazë gjërat elementare. Është bërë shfrytëzimi maksimal i hapësirë, ruajtja e hapësirë dhe planifikimi i hapësirave gjelbëruese dhe krijimi i infrastrukturës nëntokësore. Është bërë një punë e mirë dhe me kohë janë parë disa gjëra e të cilat në Kosovë thuaja se shumë pak po zbatohen dhe projektohen. Në këtë plan është bërë edhe krijimi i hapësirave urbanistiko-arkitektonke të qëndrueshme ndaj fatkeqësive natyrore.

Unë kërkoj që ta aprovojmë këtë plan i cili ndoshta edhe do të ketë ndonjë mangësi, por sa më parë që të aprovohet është më mirë.

Tahir Arifi- unë jam i bindur se gjatë hartimit të këtyre planeve rregulluese po merret parasysh gjendja faktike, por në terren për ta zbatuar këtë plan dhe shumë të tjerë paraqiten

vështirësi. Me sa di unë në këtë lagjeje e tërë prona është private, kurse në anën tjetër janë paraparë objekte dhe institucione të ndryshme. Jam kureshtar për ta ditur se a ka Komuna ndonjë plan për shpronësim të këtyre pronave, apo këto plane do të mbesin vetëm në letër?

Bahrie Mahmuti- unë së pari po i përgjigjem Arben Maliqit dhe po e theksoj se gjatë projektimit të planeve rregulluese, Drejtoria e Urbanizmit dhe kompania hartuese i ka pasur parasysh të gjitha nevojat e qytetarëve. I ka marrë në konsideratë, hapësirat gjelbëruese, parkingjet, trasimin e rrugëve etj. Gjithashtu është analizuar edhe rrejtja e largpërçuesve, por edhe i kemi marrë edhe planet nga kompanitë e ndryshme si “Hidromorava” dhe “Ecohigjiena” për t’i identifikuar kabllot nëntokësore dhe për të bërë këtë lidhje në objektet të cilat parashihen në këto zona.

Sokol Haziri- ne në fakt e kemi mbështet këtë plan në Komitetin për Politikë dhe Financa, por unë po e theksoj një dukuri shumë të shëmtuar po thuaj se në çdo lagje të qytetit tonë. Në çdo rrugë ndërtohen mure të larta deri në 3 metra të cilat mure jo vetëm që e shëmtojnë qytetin, por paraqesin edhe rrezik për kalimtarë. Është mirë që kjo dukuri jo vetëm të ndalet, por të bëhet një plan ose ndonjë projekt rregullorë dhe kjo dukurit të eliminohet, sepse kjo është një shëmti e qytetit tonë.

Florinë Zymberi – unë e lus drejtoreshën e Urbanizmit, Drejtorinë e Inspeksionit dhe organet e tjera përgjegjëse që të dalin më shpesh në terren dhe t’i identifikojnë dhe t’i ndalojnë dukuritë e këqija që po ndodhin në qytet. Në qytet janë ndërtuar shumë objekte pa leje ashtu kush si ka dashur! Për këtë arsyeje duhet të kontrollohet terreni më shumë dhe jo të dalim atëherë kur objekti është ndërtuar në 3-4 kate! Ne duhet të jemi efikas në këto gjëra dhe të ecim përpara, sepse në të kundërtën do të na shëmtohet qyteti.

Izmi Zeka- kush është për aprovim të kësaj pike të rendit të punës?

Aprovohet pika 2/3 e rendit të punës: Propozim vendimi për miratimin e Planit Rregullues Urban: ” **Qeshma e Petigovcit**, me 22 vota të anëtarëve të Kuvendit.

2/4. Propozim vendimi për miratimin e Planit Rregullues Urban: ” Gllama”,

Bahrie Mahmuti- lidhur me këtë plan drejtorja theksoi se ky plan atakon pjesën veri perëndimore të qytetit të Gjilanit dhe me lidhje të drejtpërdrejta edhe pjesët e tjera jug perëndimore, juglindore të qytetit dhe jashtë tij dhe është një hapësirë kompakte e ndërlidhur me 2 tërësi urbane: “Dardania II” dhe “Banja” “Dheu i Bardhë I” të cilat edhe më parë kanë pasur plane detale urbanistike.

Në vijim drejtorja e elaboroi këtë plan me anë të kino-projektorit.

Sokol Haziri- unë për këtë plan dhe për këtë lagje po e theksoj çështjen e gurthyesit i cili gjendet në atë zonë të qytetit i cili është një ndër ndotësit më të mëdhenj të qytetit. Nuk e kam të qartë si është trajtuar çështja e këtij gurthyesi në këto plane, sepse sipas normave së paku 500 metra duhet të jetë distanca e një objekti të tillë nga shtëpitë e

banimit. Unë e di që kjo është çështje e trashëguar, por mendoj se duhet Komuna të ketë një komunikim me ministrinë përkatëse dhe të parandalohet kjo ndotje e ambientit ! Unë kam edhe pyetje se si e ka trajtuar drejtoria këtë çështje dhe a posedon ndonjë plan për ta rregulluar këtë problematikë?

Arben Maliqi- këtë që e tha parafolësi është shumë e saktë dhe paraqet problematikë, por është e vërtetë se kjo problematikë edhe është e trashëguar. Ky gurthyes paraqet edhe rrezik për jetën e qytetarëve dhe është thuaja e pamundur të bëhet dislokimi i banorëve të asaj zone. Mirëpo për ta shndërruar në vendbanim dhe të jetojnë qytetarët është e pamundur dhe nuk lejohet. Mirëpo me sa di unë aty paraqet problem edhe tensioni i lartë ashtu siç është thënë edhe për zonat e tjera urbane.

Bahrie Mahmuti- unë po fokusohem te shqetësimi i z. Sokolit lidhur me gurthyesin e cila problematik është analizuar gjatë hartimit të planit zhvillimor urban dhe në bazë të planit zhvillimor ai gurthyes është jashtë zonës urbane. Ne e kemi menduar edhe mbrojtjen e asaj zone dhe në një të afërme nga ministritë përkatëse do të kërkohen edhe kriteret për të funksionuar një gurthyes. Në aspekt të planifikimit ne e kemi menduar që ajo të jetë zonë e pyllëzuar.

Elisah Ymeri- unë e kam një pyetje për drejtoren lidhur me hapësirat e pyllëzuara të pronave private? Çka ka bërë drejtoria dhe Komuna për t' i shpronësuar ato prona, sepse nëse parashihet të pyllëzohet një hapësirë atë se pari duhet shpronësuar! Si është vepruar në këtë rast, a është paraparë ndonjë lloj shpronësimi?

Arben Maliqi- unë e kam edhe një pyetje lidhur me këtë dhe ajo është a është paraparë edhe minimi i zonave, sepse kjo duhet të mendohet mirë, sepse aty ka shumë afër objektet të banimit!

Bahrie Mahmuti- sa i përket minimi të zonave ato janë aspekte teknologjike, por janë edhe aspekt edhe i organeve tjera profesionale i cili fakt duhet të merret parasysh në të ardhmen. Sa i përket shpronësimit të gjitha zonat të cilat destinohen për nevoja publike ato duhet të shpronësohen dhe duhet bërë një elaborat për shpronësim në bazë të nevojave prioritare. Mirëpo në këtë fazë ne duhet ta bëjmë identifikimin e pronave të cilat duhet të shpronësohen, kurse Komuna dhe ministritë përkatëse duhet ta bëjnë këtë shpronësim sipas prioriteteve.

Elisah Ymeri – unë kërkoj falje, por përsëri e pyes drejtoren se a ka Komuna mjete për t' i kryer këto obligime për shpronësim?

Bahrie Mahmtui- ne si drejtori e bëjmë planin dhe e hartojmë planin sipas nevojave, të qytetarëve, kurse sa i përket shpronësimit, Komuna duhet të kërkojë fonde të veçanta për shpronësim.

Izmimi Zeka- kush është për aprovim të kësaj pike të rendit të punës?

Aprovohet pika 2/4 e rendit të punës: Propozim vendimi për miratimin e Planit Rregullues Urban: ” **Gllama**”, me 23 vota të anëtarëve të Kuvendit.

2/5. Propozim vendimi për miratimin e Planit Rregullues Urban: ” **Dheu i Bardhë -2**”,

Bahrie Mahmuti- ky projekt –propozim e atakon rrugën qarkore në drejtim të Bujanocit, afër restauruat “Pëllumbi” ku lidhet me Dheun e Bardhë, kurse si Kufi është lumi Stanishorka, mandej lidhet me unazën e jashtme të qytetit. Në vijim të fjalës së saj drejtorja e sqaroi këtë projekt para anëtarëve të Kuvendit me anë të kino-projektorit.

Arben Maliqi- është shumë e qartë se qëllimi është më i miri dhe në vazhdimësi do të bëjmë përpjekje për t’i bërë sa më mirë gjërat. Gjithashtu e kam të qartë se drejtorja për të gjitha këto plane rregulluese ka pasur debate me qytetarë, vërejtjet e të cilëve edhe janë marrë parasysh aty ku ka pasur mundësi. Në këtë rast u përmenden dhe u thanë të gjitha ato vërejtje që i bëme për tensionin e lartë, mandej eksproprijimin etj. Mirëpo mua po më intereson diçka lidhur me lumin Stanishorka i cili lumë shpesh del edhe nga shtrati i tij dhe i bën dëme tërë qytetit, prandaj pyes a është menduar që të rregullohet shtrati i këtij lumi për të mos pasur pasoja në të ardhmen? Ato të tjerat të cilat ishin paraparë si shkolla e mesme e ulët dhe çerdhja janë të nevojshme dhe ne pajtohemi që të aprovohet ky plan rregullues.

Sokol Haziri- unë desha të pyes ku është kufiri i epërm i kësaj zone te “Qeshma e Mbretit” apo nën te nëse është e qartë ku gjendet kjo qeshmë?

Bahrie Mamuti- sa i përket lumit Stanishorka ne kemi bërë projektin për këtë qëllim, por me hartim të planit detal për këtë zonë këtë lumë do ta kemi në konsideratë. Sa i përket pyetje së Sokolit edhe unë nuk a kam të qartë se ku gjendet kjo qeshmë, por edhe i që kufiri lindor është andej lumit Stanishorka, kurse në pjesën veriore deri te Fakulteti “Fama”

Izmi Zeka- kush është për aprovim të kësaj pike të rendit të punës?

Aprovohet pika 2/5 e rendit të punës: Propozim vendimi për miratimin e Planit Rregullues Urban: ” **Dheu i Bardhë -2**”, me 22 vota të anëtarëve të Kuvendit.

2/1 Propozim vendimi për miratimin e Planit Rregullues Urban: ” **Dheu i Bardhë -1**”;

Bahrie Mahmuti- ky propozim vendim edhe më herët është përfshirë me plane detale urbanistike, mirëpo për shkak të rritjes së zonës i cili tash është plan i ri për shkak të zgjerimit të kësaj zone dhe kjo hapësirë ka një sipërfaqe prej 110 hektar. Projektuese e këtij plani është Studoi Projektuese “Urban +”, përfaqësuesi i së cilës kompani do të na jap sqarime më detale.

Ilir Gjinolli- z. Gjinolli në mënyrë detale e sqaroi këtë plan rregullues me anë të projektorëve.

Arben Maliqi- kjo që është në letër, është shumë profesionale, sepse prof. Gjinolli është edhe një ekspert i njohur, por edhe është nga Gjilani dhe jam i bindur se edhe më me përkushtim do të punojë për vendlindjen e tij.

Mirëpo unë lidhur me këto plane e kam vetëm një kërkesë që menjëherë pas aprovimit të këtyre planeve ta bëni trasimin e rrugëve, sepse nëse bëhet trasimi i rrugëve i pamundësohet gjithkujt për të bërë manipulime dhe i ndalet hovi ndërtimeve të egra. Jam për ta aprovuar këtë plan rregullues, por me këtë kërkesë që të bëhet trasimi i rrugëve?

Florinë Zymberi – ne sot patëm rastin që të debatojmë për një plan rregullues me performanca profesionale dhe bazuar në projektin e hartuar dhe në përvojën e hartuesit i cili është nga Gjilani, prandaj ky plan ka performanca të mëdha, ka profesionalizëm, ka humanizëm dhe është në nivel të një plani shumë profesional. Dëshiroj që të ndodh dhe të zbatohet në terren ky plan rregullues.

Tahir Arifi- unë dëshiroj që të ndodh në praktikë kjo çka po shohim sot në letër e që shihet se është një plan mjaft profesional i cili e bën qytetin ashtu si duhet të jetë qyteti. Unë e kam një pyetje për drejtoreshën e cila ka të bëjë me një projekt të cilin e kemi kaluar për dy-tri shtëpi për raste sociale po në këtë hapësirë. Lidhur me këtë ka pasur debate se aty do të ketë edhe ndërtime të larta të tjera për ndonjë objekt për raste sociale. Për këtë arsyeje shtroj pyetjen se a është paraparë ky objekt për këto raste sociale me këtë plan rregullues?

Bahrie Mamuti- lidhur me pyetjen e z. Tahirit, ne gjatë hartimit të planit e kemi pasur parasysh këtë dhe në tërë atë hapësirë diku afër 15 ari i kemi destinuar për objekte të banimit social.

Izmi Zeka- Kush është për aprovim të kësaj pike të rendit të punës?

Aprovohet pika 2/1 e rendit të punës: 1 Propozim vendimi për miratimin e Planit Rregullues Urban: ” **Dheu i Bardhë -1**”; me 22 vota të anëtarëve të Kuvendit.

3. Të ndryshme

Bujar Nevzadi- unë i përshëndes të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe po i përgjigjem dy pyetjeve, njërën prej të cilat në seancën e kaluar i ka bërë shefi i grupit të LDK-së, lidhur me incidentin i cili ka ndodhur në Shkollën Fillore “Thimi Mitko”.

Në kuadër të kreutimit të 100 Vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë në këtë shkollë ka ndodhur një incident në mes të drejtorit dhe ish drejtorit, për të cilin rast i kemi marrë të gjitha informatat. Ish drejtori ka hyrë në zyrë të drejtorit dhe e ka pyetur se kush i ka vendosur në mur figurat emblematike të popullit shqiptar dhe pse aty nuk gjendet fotoja e ish Presidentit Rugova? Mirëpo duhet sqaruar se këtu nuk ka të bëjë me atë se është hequr fotoja e Presidentit Rugova! Drejtori e ka sqaruar se kush i ka vendos figurat emblematike të popullit shqiptar në mur. Me këtë rast kanë filluar fyerjet dhe ish drejtori ia ka ofruar gishtin te hunda drejtorit dhe kështu ka filluar konflikti. Ne kemi marrë masa me kohë, DA i ka suspenduar që të dytë dhe i kemi dërguar në Komision disiplinor, por me këtë rast janë duke u marrë edhe policia dhe gjykata. Ne këtë rast ia kemi lënë Komisionit disiplinor dhe e tërë ngjarja është kështu dhe nuk ka asgjë tjetër. Çdo gjë tjetër që flitet është jo zyrtare!

Lidhur me emërtimin e shkollave ne kemi biseduar edhe në Komitet të Arsimit, por pasi kjo punë është e ndjeshme ne kemi vendos që këtë çështje t'ia adresojmë KPF-së dhe shpresoj se me fillim të vitit të ardhshëm do të zgjidhet edhe ky rast.

Tahir Arifi- unë po e ngrit një çështje të cilën e kam ngrit edhe njëherë tjetër e cila tani nuk e di kompetencë e kujt është kjo, por do ta kërkoj ndihmën e Drejtorisë së Urbanizmit? Unë jam nga lagjja “Arbëria” dhe në atë pjesë është një pronë publike, por e tërë prona është e ndërtuar në mënyrë të egër. Aty është gjendje kaotike, sepse aty janë 200-300 shtëpi dhe nuk e di a ka mundësi që të bëhet legalizimi i atyre shtëpive apo jo?

Mirëpo ajo pjesë faktikisht është fare pa infrastrukturë, prandaj kërkoj një përgjigje se a ekziston ndonjë mundësi që edhe për këta qytetarë këtu të bëhet ndonjë plan rregullues dhe t'iu ofrohet infrastrukturë e duhur, sepse edhe ata janë qytetarë tanë?

Elisah Ymeri- unë lidhur me emërtimin e shkollave vetëm po e tërheq vërejtjen që të kemi kujdes se si po emërtojmë këto shkolla, sepse ne kemi mjaft figura eminente, patriotike dhe shkencore që i kanë dhënë kontribut të madh kombit.

Ndërsa për drejtorinë e Shërbimeve Publike kam pyetje se a është duke i mirëmbajt ndonjë kompani rrugët apo jo?

Bahrie Mahmuti –sa i përket pyetjes së Tahirit lidhur me pronat në lagjen “Arbëria”, atë pyetje duhet ta jep Drejtoria e Kadastrit dhe ajo ta thotë fjalën në aspekt të pronës.

Ndërsa në aspekt të planeve rregulluese ne do të mundohemi që t'ia inkorporojmë, por Kadasrtri duhet ta zgjidh çështjen e pronës.

Shkëlqim Latifi- së pari po theksoj se planet të cilat i miratuam kërkoj nga sekretaria që mundësisht edhe neve të na i sjell nga një CD.

Në fillim të seancës u përmend edhe çështja e mirëmbajtjes së rrugëve e cila këtë vit nuk është nivel dhe kjo ka ndodhur edhe në drejtim të Pogragjës. Në drejtim të Pogragjës është bërë një prerje e rrugës të cilën e theksoi edhe Samiu e cila është bërë pa dijen dhe vullnetin tonë dhe të Komunës. Gjithashtu rruga është mirëmbajt vetëm deri në Uglar, prandaj kërkesë është që kompania për këtë qëllim të jetë më e kujdesshme dhe ta kryejë obligimin e sajë, sepse unë sot ka ardhur prej Pogragjës dhe e tërë rruga është e mbuluar me akull.

Lidhur me emërtimin e shkollave është mirë që të përfundojë sa më parë kjo çështje sepse ka disa vite që shkollat janë pa emër. Ne në Komitet të Arsimit e kemi dhënë pëlqimin dhe është koha e fundit që edhe ato shkolla ta kenë emrin e vetë.

Behar Mehmeti- në fillim të seancës mua m' u bënë 4 pyetje, por grupi parlamentar i LDK-së nuk është në sallë dhe nuk e di sa ka nevojë të përgjigjem në ato pyetje.

Unë po përgjigjem në dy pyetje për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve dhe për mirëmbajtjeve verore për fshatin Pogragjë e cila pyetje u bë nga Samiu dhe Shkëlqimi.

Në mjetet e informimit dje ka qenë një prononcim nga Zyra e Prokurimit dhe nga Zyra e Kryetarit dhe nga DSHP lidhur me mirëmbajtjen e rrugëve në TV “VALI”.

Ne si DSHP, projektin për mirëmbajtje të rrugëve në përgjithësi për komunën tonë e kemi bërë publik diku nga fundi i muajit shtator e që do të thotë më herët se vitin e kaluar.

Në Zyre të Prokurimit janë zhvilluar procedurat dhe është bërë vlerësimi për kompanitë konkurruese dhe është nxjerr një përfitues, por në fazën e ankesave në OSHP është bërë një vonesë mbi 1 muaj. Sot e kam marrë lajmin se ka ardhur një përgjigje nga OSHP dhe sot komisioni është në takim prej orës 9 për rivlerësim dhe shpresoj se brenda dy-tri dite do ta kemi operatorin i cili do t'i mirëmbajë rrugët dhe do ta kemi adresën e saktë se kujt duhet t' i drejtohem?

Unë dje i kam inspektuar arteriet kryesore të rrugëve të cilat na dërgojnë në fshatrat kryesore dhe kam qenë në regjionin e Pogragjës dhe informacionin e kam se kompania vullnetarisht nëpër qendrat kryesore ka hedh krip, kurse në drejtim të Pogragjës dhe të Zhëgrës dje është bërë një intervenim. Mirëpo për fat të keq nuk kemi arrit të rruga e Përlepnicsës për të cilin rast kërkoj falje.

Këtë vit është gjendja pak më shqetësuese, sepse vitin e kaluar kemi qenë shembull, kurse këtë vit në këto ditë nuk kemi kompani dhe gjendja është më e rëndë. Mirëpo po besoj që shumë shpejt do ta kemi dhe do të zgjidhet edhe ky problem.

Aktualisht përkohësisht është duke vepruar vullnetarisht kompania "Tali" derisa të zgjidhet problemi i zyrtarizmit të ndonjë kompanie.

Çështja e pastrimit të trotuareve dhe shkollave është përgjegjëse "Eco Higjiena" dhe ju e keni parë se sot në mëngjes është hedhur kripë nëpër trotuare dhe nëpër oborre të shkollave.

Sa i përket mirëmbajtjes verore e keni në raport te mirëmbajtja verore nëse e keni lexuar në raport fatkeqësisht i kemi pasur disa vonesa te kalimi i pjesëve rurale për mirëmbajtje verore dhe kompania e cila ka qenë përgjegjëse nga sektori i menaxhimit të kontratave i cili ka dhënë vërejtje, por kohëve të fundit është filluar me një intensitet më të madh për të punuar dhe jemi munduar që të shkojmë në ato zona ku kemi mbetur prapa.

Në momentin që e kemi përfunduar rrugën në drejtim të Velekicës dhe Malishevës, kanë filluar të reshurat e borës dhe tash kushtet atmosferike nuk lejojnë që të punohet.

Vullneti ekziston për të vazhduar edhe në drejtim të Pogragjës, por kushtet klimatike nuk lejojnë.

Me këto debate seanca i përfundoi punimet në ora 12.45 min.

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

Izmi ZEKA